



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 07.02. 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Ismet Beqiri Fatmir Xhelili, Fadil Beka dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Përfaqësuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës: Gjenerallejtënant Rrahman Rama, Kolonel, Jeton Dreshaj, Shemsi Sylja, Dhurata Kryeziu-OSBE, Luanda Domi-DCAF

Munguan: Ramiz Kelmendi, Drita Millku

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Raportimi i Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Rrahman Rama për raportin vjetor të punës për vitin 2017.

Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari, lidhur me pikën e vetme të rendit të ditës fillimisht fjalën ia kaloi Komandantit të FSK-së, për të paraqitur raportin për vitin 2017 dhe për të vazhduar më pas me pyetjet e deputetëve.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, Komandant i FSK-së, lidhur me raportin vjetor për vitin 2017, theksoi se është i fokusuar në objektivat e ministrit të FSK-së, për të arritur qëllimin e FSK-së. Më tej ai theksoi se në pesë vitet e fundit, FSK-ja është renditur e para dhe vazhdon të renditet edhe me përqindje më të lartë, duke shtuar që kjo ka ardhur nga angazhimi i të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, duke kërkuar që është përgjegjësi të mbahet ky pozicion. Gjithashtu theksoi se një aspekt, ku është treguar sukses, ka qenë deminimi, ku 7 milion metër katrorë, janë pastruar. FSK-ja ka dëshmuar që është forcë e gjithë qytetarëve dhe është mulietnike. Aktualisht janë 110 fusha atë minuara dhe kjo çështje do të marrë kohe edhe për dhjetë vite.

Nga viti i kaluar është arritur që të funksionalizohet Qendra Rajonale e Kërkim Shpëtimit, ku është ofruar mbështetje për Shqipërinë dhe do të ofrohet për të gjithë partneret, përveç shtetit të Kosovës. Tutje, ai theksoi se FSK-ja ka pasur të arritura individuale dhe kolektive në trajnimet jashtë vendit, gjithashtu FSK-ja është pjesë e trajnimeve rajonale. FSK-ja ka marrë pjesë në ushtrime regjionale dhe performanca e pjesëtarëve të FSK-së ka qenë e lartë.

Në ushtrimin fushor “Shqiponja 5”, janë ftuar parterët me të cilët kemi bashkëpunim si dhe KFOR-i, ku prej dy vitesh realizohen ushtrime të përbashkëta që do të fillojnë në muajin maj. Rama theksoi dislokimin e fundit humanitar që është bërë me rastin e vërshimeve, ku me kërkesën e Shqipërisë kanë pranuar të shkojnë duke respektuar të gjitha procedurat ligjore.

E arritur tjetër është vizita në shtetin e Ajovas , ku përgjatë vitit 2017, janë realizuar 110 aktivitetet të përbashkëta, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Partneriteti shtetëror(*state partnership*) është i mirë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se bashkëpunimi do të rritet në vazhdimësi.

FSK-ja ka 12 marrëveshje bilateral me shtetet e caktuara, ndërsa 6 marrëveshje janë në proces. Gjithashtu, Rama theksoi se FSK-ja mban Konferencën në muajin prill me temën “FSK-ja dhe parterët”.

Gjatë vitit 2018, do të ketë aktivitete dhe konferenca të tjera, në gjashtë vende janë kadetë, siç është West Point-i, ku kadetët janë në vitin e dytë, dhe nga informacionet që kam, kadetja femër është më e mira e gjeneratës.

Sa i përket integritet të komunitetit serb në kuadër të FSK-së, janë bërë ndryshime pozitive, ku janë rekrutuar gjatë shtatë muajve të fundit, 61 serbë janë pjesë e FSK-së, dhe nga rekrutimi i fundit 34 pjesëtar serbë nga veriu i Kosovës, janë duke u trajnuar dhe do të jenë pjesë e FSK-së. Aktualisht FSK-në e përbëjnë 12 përqind e minoriteteve dhe kështu do të mbetet.

Progresi është i mirë, dhe të gjitha minoritet janë integruar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është aspekt tjetër i rëndësishëm, ku ekipi këshillues i NATO-s, që udhëhiqet nga një gjeneral gjerman, e ndihmon FSK-në përgjatë gjitha proceseve dhe janë të kënaqur me angazhimin e tyre dhe do të vazhdohet edhe më tutje.

Sfidat janë pjesë e punës, dhe sa i përket transformimit, FSK-ja është e gatshme në çdo moment të implementojë planin pasi është bërë rishikimi i sektorit të sigurisë në vitin 2014, dhe në vazhdimësi janë bërë përgatitjen këtë çështje . Përkrahja e madhe ka qenë nga partnerët strategjik

dhe të gjitha gjërat janë në vendin e tyre. FSK-ja do të jetë transparente si me aktorët vendorë, dhe ndërkombëtarë, dhe qëllimi është që të krijohet institucioni që të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në shërbim të sigurisë së Kosovës.

FSK-ja përgjatë vitit 2017 ka realizuar disa projekte humanitare dhe kjo është arsyeja që është institucion më i besueshëm, duke ofruar shërbime për qytetarët. Kemi projekte edhe me KFOR-in, siç ka qenë rasti i renovimit të urës në Mitrovicë. Sfidë ka qenë edhe shfrytëzimi i buxhetit pasi ka burokraci në procesin e prokurimit, duke shtuar që nga ana e SHBA-së janë ofruar 9.2 milion dollar për pajisjet e komunikimit. Synim i FSK-së është që të jetë i ndërveprueshëm me partnerët ndërkombëtarë, gjithashtu edhe nga shteti turk janë ofruar 2 milion dollar.

Po ashtu, është edhe “*trust found*” nga NATO-ja që mbështesin FSK-së. Gjatë vitit 2018, do të jetë donacioni nga SHBA-ja prej 5 milion dollarëve për xhip taktikë.

Rama theksoi se disa pajisje do të blihen nga vet FSK-ja, dhe janë përkrahur nga ana e Qeverisë për të shmangur nga disa procedura burokratike, pasi pajisjet e tilla kanë specifikat e veta dhe është e vështirë gjetja e kompanive adekuate dhe të licencuara.

Kryetari, falënderoi për raportimin, duke shtuar se në vizitën e realizuar në selinë e NATO-s, kanë marrë vetëm lëvdata për punën e FSK-së. Gjithashtu përgëzoi për punën dhe për faktin që nuk ka pasur asnjë denoncim për ndonjë keqpërdorim të mundshëm, gjithashtu edhe për fushatën për integrimin e komunitetit serb në kuadër të FSK-së. Tutje shtroi pyetjen. Si qëndron çështja e kazermave në kuadër të FSK-së?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se me kapacitetin aktual dhe investimet e bëra, është krijuar komoditet për të gjithë pjesëtarët e FSK-së. Disa projekte të filluara në vitin 2015, kanë përfunduar më 2017, dhe mund të thuhet që infrastruktura aktuale dhe projektet për të ardhmen, do të duhen edhe pak investime për strukturën e ardhshme dhe për numrin më të madh të pjesëtarëve të FSK-së.

Rexhep Selimi, duke iu referuar Raportit të Progresit, i cili kishte theksuar që Komisioni është i “*but*” në mbikëqyren e FSK-së, gjë që nuk qëndron. Tutje theksoi se FSK-ja është institucioni i besueshëm dhe që përkrahët nga të gjithë, duke manifestuar nevojën e qytetarëve të Kosovës për forcën ushtarake. Selimi theksoi se mbështetja e Komisionit do të jetë në mbështetje për proceset në Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke shtuar që Komisioni do kërkojë, kur të jetë nevoja nga Ministria e FSK-së për mbështetjen e FSK-së, duke shtuar që nga vizita në Asambleenë Parlamentare e NATO-s, janë diskutuar disa çështje, duke u veçuar raporti i mirë mes NATO-s dhe FSK-së, që për arsye të caktuara quhet raport ndërveprimi dhe ekziston mbështetja për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, duke shtuar që ndihet mirë që në uniformën e FSK-së po rritet ushtria e ardhshme e Kosovës, duke shpresuar që shpejt të raportojnë si Forcë e Armatosur.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, theksoi se FSK-ja është pjesë e 12 shkollave të NATO-s, ndërsa sa i përket korit të atasheve është zgjeruar, ku përveç 6 shteteve, në fillim të vitit të ardhshëm do të vendosen në Francë dhe në Itali.

Fatmir Xhelili, theksoi se rezultatet e FSK-së, kanë bërë që të ndjehen krenar dhe vlerësoi punën e arritur në FSK. Tutje kërkoi që të bëhet një sqarim, lidhur me termin transformim, i cili është një proces për arritjen kapaciteteve të plota. Sa i duhet kohë për realizimin e një procesi të

tillë? A mund të quhet proces i modernizimit, deri sa të merret vendimi politik? Sa është duke u zhvilluar njësia për mjetet improvizuese shkatërruese? A ka raste kur mund të aktivizohet në raste të tilla? Apo jeni në fazën e improvizimeve, marrë në konsideratë veprimet terroriste? Gjithashtu theksoi se e gëzon fakti për organizimin e ushtrimit fushor “Shqiponja 5”, dhe kërkoi të di nëse marrin pjesë edhe segmentet e tjera të sigurisë, siç është Policia e Kosovës, emergjencat?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, Komandant i FSK-së, tha se sa i përket njësisë së deminimit, janë në bashkëpunim me KFOR-in amerikan dhe janë në trajnim të vazhdueshëm në këtë fushë dhe FSK-ja ka pajisjet dhe mjetet e sofistikuar. Ndërsa sa ai përket ushtrimit fushor, theksoi që ky ushtrim do të jetë ndërkombëtar dhe do të përfshihen të gjithë aktorët e sigurisë duke përfshirë shoqërinë civile, spitalet dhe kryqin e kuq. FSK-ja ka njësinë K9 (Njësinë e qenve) që merren me këtë çështje, duke shtuar që në aspektin profesional janë të gatshëm. Ndërsa s ai përket procesit të transformimit, theksoi se i duhet një periudhë kohore për procesin e transformimit, ndërsa sa i përket infrastrukturës dhe pajisjes, Rama theksoi se janë në përdorim dhe do të përdorën edhe më vonë, duke e quajtur këtë proces si transicion.

Tutje theksoi që Kosova ka nevojë të mbajë këto kapacitete (kërkim shpëtim, deminim), deri sa të bëhet transicioni komplet, pasi kjo merr kohë. Sa i përket implikimeve buxhetore, Rama theksoi se me qëllim që mos të bëhet pengesë e madhe buxhetore, është menduar që për çdo vit të ndahen nga buxheti 5.5 milion euro e edhe ky proces do të marrë pak kohë.

Ismet Beqiri, vlerësoi të arriturat e FSK-së, duke konsideruar të rëndësishëm aspektin e partneritetit, bashkëpunimit me faktorin ndërkombëtar, pasi edhe shtetet më të rëndësishme funksionojnë nën ombrellën e NATO-s. Beqiri theksoi se janë bërë ndryshime pozitive që nga strukturat e para të ish TMK-së, duke e vlerësuar se procesi i transformimit merr kohë, duke shtuar që mbështetja do të jetë nga ana e Komisionit. Gjithashtu kërkoi që të jenë sa më prezent në popull, duke njoftuar të gjithë qytetarët me punën e tyre, me përgatitjet e tyre, duke e konsideruar të nevojshëm bashkëpunimin me parterët ndërkombëtarë për këtë çështje.

Muharrem Nitaj, fillimisht theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është një sentiment dhe vlerë dhe ndoshta mund të hezitojmë të përmendet ndonjë gjë që nuk funksionon. Duke iu referuar raportimit të komandantit, theksoi se duket që funksionon çdo gjë mirë. Nitaj theksoi se dëshiron të dijë më shumë se çfarë do të bëjë FSK-ja që pas vendimit politik të arrihet në një periudhë më të shkurtër? Cila është përqindja gjinore, mosha, shkollimi, kuadri? Cili është përfaqësimi rajonal? Sa është numri i pjesëtarëve të FSK-së? Cili është plani për pesë vitet e ardhshme? Cilat janë mundësitë, që me statusin që ka, ti përngjajë një forca ushtarake dhe një organizatë civile-ushtarake, njësia e helikopterëve?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se FSK-ja ka 2500 pjesëtarë aktivë, 300 rezervë, 8 për qind të femrave që shërbejnë në FSK, 10.2 për qind janë minoritete, grada më e lartë është kolonel. Tutje theksoi se edhe komponenti rezervë është trajnuar në fshatë caktuara. Ndërsa s ai përket asaj që FSK-ja duhet të duket si ushtri, theksoi se janë ligjet në fuqi që nuk lejojnë një gjë të tillë, ndërsa sa i përket të arriturave të FSK-së, theksoi se është Qendra e Studimeve Universitare në kuadër të FSK-së që është një mekanizëm i rëndësishëm. Shkurtimi i periudhës mund të bëhet, nëse ka interes shteti, duke shtuar që FSK-ja është e gatshme të shtyjë tutje proceset. Ndërsa sa i përket Njësisë së Helikopterëve, theksoi se kjo njësi është por pilotët janë

duke u shkolluar në shtete të caktuara, pasi minimumi duhet të jenë 4 pilotë dhe gjashtë teknikë për një helikopter. Gjithashtu theksoi se me ish- Kryeministrin është diskutuar që çështja e pilotëve të jetë një projekt nacional, ku do të përfshiheshin edhe fusha të tjera.

Zoran Mojsilović, fillimisht përshëndeti Komandantin e FSK-së, dhe falënderoi për raportim. Tutje theksoi e nga vizita që është realizuar në Ministrinë e FSK-së dhe në FSK, Komisioni është njoftuar me problematikat që përballen në blerjen e pajisjeve të veçanta, si pengesë e procesit të prokurimit. Lidhur me këtë çështje, shtroi pyetjet si në vijim: A do të ketë problem FSK-ja me Ligjin e Prokurimit? A do të ketë marrëveshje ose zgjidhje për këtë çështje?

Gjithashtu, ai shtroi çështjen e përfaqësimit të komunitetit serb në kuadër të FSK-së. A është numri i njëjtë i pjesëtarëve të FSK-së, ashtu siç është prezantuar në takimin e kaluar që ishte 103 pjesëtarë apo ka ndryshuar?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, theksoi se nga vizita që është bërë në FSK nga Komisioni, theksoi e ka humbur një pjesë e buxhetit për shkak të burokracive dhe mos gjetjes së kompanive të specializuara. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim, që për pajisjet e veçanta të revokohet Neni 3 i Ligjit të Prokurimit, që i mundëson FSK-së, blerjen e pajisjeve të tilla që janë në shërbim të qytetarëve dhe i japin mundësi FSK-së të bëjnë pajisje specialistike. Ndërsa sa i përket numrit të serbëve, theksoi se në total janë 103, ndërsa 34 janë akoma në trajnim, dhe nëse i kalojnë të gjitha fazat bëhen 137, që në përqindje do të jenë 6 për qind, ndërsa 12 për qind është për të gjitha minoritetet.

Bahrim Shabani, falënderoi Komandantin për raportimin dhe shtroi çështjen e përfaqësimit të komunitetit boshnjak në kuadër të FSK-së. Gjithashtu theksoi se vjen nga qyteti i Prizrenit, ku ka komunitet boshnjak dhe konsideroi që nuk është mirë i përfaqësuar në FSK, marrë parasysh përqindjen e këtij komuniteti që nuk është i vogël.

Rrahman Rama, theksoi se nuk ka përmendur në detaje, duke theksuar vetëm përqindjen në total, 54 janë boshnjak në të gjitha nivelet dhe nuk ka pasur problem për integrimin e tyre, dhe bëhet përpjekje që sipas përqindjes ku jetojnë, të përfaqësohen edhe në FSK. Ndërsa s ai përket emrave, theksoi se mund të dërgohen me të gjitha detajet.

Bahrim Shabani, shtroi çështjen e gradimeve në kuadër të FSK-së. A ka pasur nga komuniteti boshnjak që janë graduar?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha se në gradimin e përmendur nga z.Shabani, kanë qenë 3 serbë, një turk dhe një ashkali, duke shtuar që gradimet bëhen nga bordet dhe çdo pjesëtar i FSK-së, është i obliguar që të shërbejë tre vite në FSK dhe më pas të gradohet dhe varësisht nga njësia ku shërben dhe specialiteti që ka, pra merren për bazë disa kritere. Nga komuniteti boshnjak ka pjesëtar që kryejnë trajnime dhe janë të integruar.

Xhelal Sveçla, falënderoi për raportimin dhe pyeti a përgatisin raport për situatën e sigurisë në vend? A janë plotësuar të gjitha nevojat për armatim, në kuadër të mandatit aktual? A mund të kalohen kufizimet në të cilat ndodhet FSK-ja?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama, theksoi se obligimet e FSK-së janë kryer, ndërsa tashmë është në mandatin politik për të proceduar tutje. Ndërsa, sa i përket përgatitjes së raportit për siguri, theksoi se bashkëpunimi ekziston më të gjithë aktorët e sigurisë në vend si dhe KFOR-in.

Haxhi Shala, kryetar, falënderoi për raportimin e bërë Gjenerallejtënant Rahman Rama, Komandantit të FSK-së, dhe shprehu vlerësimin për të arriturat e deritanishme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Haxhi Shala